



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË**  
**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**NJOFTIM PËR MEDIAT**

**1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurve **Florian Habilaj, Armando Sulaj, Sabaudin Çelaj dhe Tigrens Mëzuraj**”.

**2.** Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të shkurtuar. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Esmeralda Xhili, Arbana Selmanaj dhe Migena Laska, me vendimin nr. **79**, datë **05.12.2025** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florian Habilaj**, për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, mbetur në tentativë në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 22, 28/4 të Kodit Penal, si edhe në bazë të nenit 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim.
- 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florian Habilaj**, për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 28/4 të Kodit Penal, si edhe në bazë të nenit 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15 (pesëmbëdhjetë)vjet burgim.
- 3.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Florian Habilaj**, për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/1 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3 (tre) vjet burgim.
- 4.** Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Florian Habilaj** me një dënim të vetëm prej 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.
- 5.** Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, dënimin të të pandehurit **Florian Habilaj** t’i zbritet një e treta e masës së dënimin dhe përfundimisht dënohet me 10 (dhjetë) vjet burgim.
- 6.** I pandehuri **Florian Habilaj** t’ a vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë.
- 7.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Armando Sulaj**, për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 28/4 të Kodit Penal, si edhe në bazë të nenit 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 9 (nëntë) vjet burgim.
- 8.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Armando Sulaj**, për veprën penale “Grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.

9. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Armando Sulaj** me një dënim të vetëm prej 9 (nëntë) vjet burgim.
10. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, dënimit të të pandehurit **Armando Sulaj** t'i zbritet një e treta e masës së dënimit dhe dënohet përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet burgim.
11. I pandehuri **Armando Sulaj** t'a vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë.
12. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Sabaudin Çelaj**, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 28/4 të Kodit Penal, si edhe në bazë të nenit 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 15(pesëmbëdhjetë)vjet burgim.
13. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Sabaudin Çelaj**, për veprën penale "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 3(tre) vjet burgim.
14. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Sabaudin Çelaj**, me një dënim të vetëm prej 15(pesëmbëdhjetë) vjet burgim.
15. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, dënimit të të pandehurit **Sabaudin Çelaj**, t'i zbritet një e treta e masës së dënimit dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 10 (dhjetë) vjet burgim.
16. I pandehuri **Sabaudin Çelaj**, ta vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë.
17. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Tigrens Mëzuraj**, për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim, në formën e posaçme të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1, 28/4 të Kodit Penal, si edhe në bazë të nenit 334/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 8 (tetë)vjet burgim.
18. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Tigrens Mëzuraj**, për veprën penale "Grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga neni 333/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e tij me 2 (dy) vjet burgim.
19. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në caktimin e dënimeve për disa vepra penale, dënimin e të pandehurit **Tigrens Mëzuraj**, me një dënim të vetëm prej 9 (nëntë) vjet burgim.
20. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, dënimit të të pandehurit **Tigrens Mëzuraj**, t'i zbritet një e treta e masës së dënimit dhe përfundimisht i pandehuri dënohet me 6 (gjashtë) vjet burgim.
21. I pandehuri **Tigrens Mëzuraj** t'a vuajë dënimin në një burg të sigurisë së lartë.
22. Shpenzimet procedurale gjatë fazës së hetimit si dhe shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim të pandehurve në mënyrë solidare.
23. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim nga palët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

**Tiranë, më datë 05.12.2025**

**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**